Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -4-
Nr.Prot. / Broj Prot. / Prot.No: 05-10125
Njesia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 02
Data / Datum / Date: 24/12/2024
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*
*Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva*

# PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

EMRI I PSO: REKRUTIMI I PERSONELIT SHTESË NË QENDRËN OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK

PËRMBAJTJA: PSO PËRSHKRUAN PROCESIN E REKRUTIMIT TË PERSONELIT SHTESË PËR QENDRËN OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK, DUKE SIGURUAR NJË STRUKTURË TË FUQIZUAR PËR MENAXHIMIN E SITUATAVE EMERGJENTE

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 24/12/2024
AUTOR: MSh
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 16

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh

v.v

| | |
|---|---|
| QËLLIMI | QËLLIMI I KËSAJ PSO-JE ËSHTË OFRIMI I NJË STANDARDI PËR PËRZGJEDHJEN, ANGAZHIMIN DHE DISLOKIMIN E PERSONELIT SHTESË PËR REAGIM. REAGIMI I SUKSESSHËM EPIDEMIK (RASTI SHËNDETËSOR) VARET DREJTPËRDREJT NGA EKSPERTIZA, KOMPETENCA, AFTËSITË DHE QËNDRIMET E PERSONELIT QË MERR PJESË NË REAGIM.<br>PSO DO TË PËRDORET NGA QOESHP DHE PARTNERËT PËR IDENTIFIKIMIN DHE TUBIMIN (MOBILIZIMIN OSE SIGURIMIN) E PERSONELIT PËRKATËS PLOTËSUES PËR MBËSHTETJEN E REAGIMIT.<br>PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E KËSAJ PSO ËSHTË GRUPI I VEÇANTË I PUNËS PËR RASTIN I CILI UDHËHEQET NGA SPECIALISTI I SHËNDETIT PUBLIK |
| NDËRLIDHJA ME AKTET | • LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI<br>• LIGJIN NR.08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE,<br>• STRATEGJIN SEKTORIALE E SHËNDETËSISË 2025-2030. |
| LISTA E SHKURTESAVE | QOESHP – QENDRA OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK<br>MSH- MINISTRIA E SHËNDETËSISË<br>IKSHPK- INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK |

## PROCEDURA

| an | HAPI | NËN-HAPAT |
|---|---|---|
| I | Ri-caktimi i personelit, pas shpalljes së emergjencës së shëndetit publik | 1. Ministria e Shëndetësisë, në rastet e emergjencës së shëndetit publik, në koordinim me IKSHPK dhe institucionet e tjera publike shëndetësore, identifikon nevojat për mbështetje me kapacitete njerëzore plotësuese të profesionistëve shëndetësor dhe staf mbështetës. |
| II | Detyrat e QOEShP | 1. QOEShP mirëmban dhe përditëson rregullisht bazën e të dhënave të personelit përkatës të aftë dhe të larmishëm lokal.<br>2. Pas shpalljes së një rasti/ngjarjeje të shëndetit publik, menaxheri i QOEShP, bën një analizë për ta përcaktuar numrin burimeve njerëzore të nevojshme në kuptimin e shkathtësive dhe ekspertizës.<br>3. Analiza i dërgohet kryesuesit të Grupit të veçantë të punës për rastin/ngjarjen për nevojat për burime njerëzore.<br>4. Drejtori ekzekutiv i IKShPK-së i parashtron kërkesën MSh-së për resurset e nevojshme njerëzore të cilat duhet të plotësohen. |
| III | Rishikimi i personelit në dispozicion kundrejt personelit të nevojshëm për reagim. | 1. Kryesuesi i Grupit të veçantë i prezanton drejtorit të IKSHPK-së nevojat për personel shtesë bazuar në të dhënat e analizuara dhe nevojat e reja, bashkë me arsyetimet për profilet e kërkuara të personelit shtesë |
| IV | Kërkesa për personel shtesë brenda dhe jashtë institucionit | 1. Drejtori ekzekutiv kërkon fillimisht personel shtesë brenda institucionit për dislokim të mundshëm<br>2. Nëse brenda institucionit nuk ka personel shtesë që mund të angazhohet, drejtori ekzekutiv përmes MSH-së, kërkon personel shtesë brenda ose jashtë institucionit dhe vendit, për të plotësuar boshllëqet e identifikuara. |
| V | Angazhimi i personelit shtesë, trajnimi dhe monitorimi i punës së tyre . | 1. MSh hap konkurs për rekrutim të personelit me procedurë të përshpejtuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.<br>2. Personeli rekrutohet ose angazhohet sipas procedurave të lehtësuara për angazhim në kohë më të shpejtë në QOEShP.<br>3. IKSHPK dërgon personelin e vet në Komisionin e rekrutimit për të bërë përzgjedhjen e profileve të nevojshme.<br>4. Pas procesit të përzgjedhjes, personeli i rekrutuar trajnohet shpejt për përgjegjësitë lidhur me menaxhimin e ngjarjeve/incidenteve -situatave emergjente<br>5. Pas marrjes së trajnimit bazë, personeli shtesë dislokohet në detyrat që caktohen nga menaxhmenti i IKShPK-së |

| | | |
|---|---|---|
| | | 6. Grupi i veçantë i punës për rastin/ngjarjen e shëndetit publik rishikon rregullisht performancën e personelit shtesë bazuar në evoluimin e rasti/ngjarjes së shëndetit publik.<br>7. Personeli rekrutohet ose angazhohet sipas procedurave të lehtësuara për angazhim në kohë më të shpejtë në QOESHP. |
| VI | Detyrat dhe përgjegjësitë | 1. Drejtori Ekzekutiv i IKShPK-së është përgjegjës për Memorandumet e Mirëkuptimin midis IKShPK-së dhe institucioneve të tjera që ofrojnë personel shtesë. |